FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2016 – Numri: 169

Tiranë – E premte, 9 shtator 2016

PËRMBAJTJA

		Faqe
Dekret i Presidentit nr. 9727, datë 1.9.2016	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare	20347
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 610, datë 31.8.2016	Për ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit, nga Ministria e Kulturës dhe "Alba Film" sh.a., te Ministria e Arsimit dhe Sportit, të pasurive të paluajtshme në zonën kadastrale nr. 8130	20347
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 614, datë 31.8.2016	Për ekzekutimin e vendimit të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, datë 7.4.2016, për çështjen "Karagjozi dhe të tjerë kundër Shqipërisë" (për ankimin nr. 32382/11)	20350
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 615, datë 31.8.2016	Për ekzekutimin e vendimit të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, datë 7.4.2016, për çështjen "Aliçka dhe të tjerë kundër Shqipërisë" (për ankimet nr. 33148/11, nr. 33151/11, nr. 33823/11, nr. 46103/11, nr. 72334/11 dhe nr. 78960/11)	20351
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 616, datë 31.8.2016	Për një ndryshim në vendimin nr. 1080, datë 23.12.2015, të Këshillit të Ministrave, "Për ekzekutimin e vendimit të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, datë 10.11.2015, për çështjen "Sharra dhe të tjerë kundër Shqipërisë" (për ankimet nr. 25038/08, 64376/09, 64399/09, 347/10, 1376/10, 4036/10, 12889/10, 20240/10, 29442/10, 29617/10, 33154/11 dhe 2032/12)"	20353
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 617, datë 31.8.2016	Për emërimin në detyrë të drejtorit të përgjithshëm të Teatrit Kombëtar të Operës, Baletit dhe Ansamblit Popullor	20353
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 618, datë 31.8.2016	Për financimin e Urdhrit Profesional të Mjekut Veterinar	20353
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 619, datë 31.8.2016	Për një ndryshim në vendimin nr. 33, datë 20.1.2016, të Këshillit të Ministrave, "Për financimin e shërbimeve shëndetësore spitalore nga skema e detyrueshme e sigurimeve të kujdesit shëndetësor për vitin 2016"	20354

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 620, datë 31.8.2016	Për hapjen e procedurës së pranimit të drejtpërdrejtë në TND edhe për kandidatë të tjerë, jashtë shërbimit civil, dhe për përdorimin e procedurës së pranimit të drejtpërdrejtë në TND, për vitin 2016.....	20355
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 621, datë 31.8.2016	Për lirim dhe emërim në detyrë.....	20356
Udhëzim i ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë nr. 17, datë 30.8.2016	Mbi zbatimin e vendimit nr. 618, datë 7.9.2006, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e kritereve të dokumentacionit dhe masës së përfitimit të pagesës për personat me aftësi të kufizuar", të ndryshuar	20356
Udhëzim i ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë nr. 18, datë 30.8.2016	Mbi zbatimin e vendimit nr. 277, datë 18.6.1997, të Këshillit të Ministrave, "Për përfitimet nga statusi i të verbrit", të ndryshuar.....	20357
Udhëzim i ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë nr. 19, datë 30.8.2016	Mbi zbatimin e vendimit nr. 31, datë 20.1.2001, të Këshillit të Ministrave, "Për përfitimet nga statusi i invalidit, paraplegjik dhe tetraplegjik", të ndryshuar.....	20357
Urdhër i ministrit të Drejtësisë nr. 5993, datë 7.9.2016	Për delegim kompetence.....	20357
Kërkesë e Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës nr. 4266, datë 2.9.2016	Për shpronësim për interes publik të pasurive të paluajtshme pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor "By-pass Vlorë (objekte) ".....	20358
Kërkesë e Ministrisë së Zhvillimit Urban nr. 4810, datë 2.9.2016	Për shpronësim për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private që preken nga realizimi i projektit "Sistemimi i bllokut të banimit në lagjen "Kongresi i Lushnjës", pallati 31, tek ish-kinemaja" Lushnjë.....	20359

DEKRET
Nr. 9727, datë 1.9.2016

PËR LEJIMIN E LËNIES SË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, pika "c" dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe të neneve 15 e 20, të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998, "Për shtetësinë shqiptare", të ndryshuar, bazuar edhe në propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, personave të mëposhtëm:

1. Aida Selamet Hamzi
2. Suela Zihni Haxhiraj
3. Olivera Josif Schmidt (Adhami)
4. Semiha Beqir Rami (Muka)
5. Xhejni Gëzim Fyshku
6. Kristian Viktor Gjinaj
7. Hanë (Hane) Zef Volaj (Mitaj)
8. Arbër Jenisher Liçaj
9. Brikena Ferit Çeribashi (Vrapi)
10. Agron Ruzhdi Alla
11. Anila Rexhep Alla (Isufaj)
12. Aurela Agron Alla
13. Olsa Idris Palamani
14. Erand Novrus Zeka
15. Sabina Bardhyl Dani
16. Violeta Leko Zlatičanin (Savoja)
17. Ronaldo Besnik Rreshka
18. Gerta Jurgen Treska
19. Eduard Jonaq (Janaq) Shoro
20. Mirela Abdi Shoro (Gorenca)
21. Fiona Eduard Shoro

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bujar Nishani

VENDIM
Nr. 610, datë 31.8.2016

PËR NDRYSHIMIN E PËRGJEGJËSISË SË ADMINISTRIMIT, NGA MINISTRIA E KULTURËS DHE "ALBA FILM", SHA, TE MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT, TË PASURIVE TË PALUAJTSHME NË ZONËN KADASTRALE NR. 8130

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 8, 10, 13, 15 e 16, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, "Për pronat e paluajtshme të shtetit", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit, nga Ministria e Kulturës te Ministria e Arsimit dhe Sportit, të pasurisë së paluajtshme me emërtimin "Lulishte", në zonën kadastrale nr. 8130, me indeks harte TR-I, J-17, 18 dhe nr. 4/88 pasurie, me sipërfaqe 2000 (dy mijë) m^2 truall (ish-Kinostudio), sipas planvendosjes bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi.

2. Ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit, nga "Alba Film", sh.a., te Ministria e Arsimit dhe Sportit, të pasurive të paluajtshme në zonën kadastrale nr. 8130, me indeks harte TR-I, J-17, 18, me sipërfaqe 1906.5 (një mijë e nëntëqind e gjashtë pikë pesë) m^2 truall dhe sipërfaqe 1575.1 (një mijë e pesëqind e shtatëdhjetë e pesë pikë një) m^2 objekt (ish-Kinostudio), sipas planvendosjes bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi.

3. Ministria e Arsimit dhe Sportit nuk mund ta tjetërsojë apo ndryshojë destinacionin e pronave të përcaktuara në pikat 1 dhe 2, të këtij vendimi.

4. Ngarkohen ministri i Arsimit dhe Sportit, ministri i Kulturës, Agjencia e Inventarizimit dhe Transferimit të Pronave të Paluajtshme dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama


PLAN VENDOSJA E OBJEKTIT ISH STUDIO E ZERIT
ALBA FILM SH. A SIP. S= 1906.5M2 , Pasuria Nr. 4/88, 4/267
SIPERFAQE NDERTIMI ISH STUDIO ZERIT kati perdhe S= 846.7M2
kati i dyte S= 583.4m2
bodrum S=145.0m2
Shuma S=1575.1m2
sheshi funksional = 1059.8m2
ZONA KADASTRALE 8130, ME INDEKS HARTE TR - I, J - 17, 18
Pergatiti : TOPOGRAF PETRIT KULLOLLI
PETRIT KULLOLLI
Liç. nr. TZ 1371/ 3
TIRANA - ALBANIA
5/166
RR.ALEKSANDER MOJSIU
4/147
ALBA FILM SH.A
S=1906.5M2
4/88
LULISHTE
4/88
4/88
4/88
4/147
MINISTRIA E KULTURES
TR; I,J-17,18
8130
TIRANE


PLAN VENDOSJA E LULISHTES MINISTRIA KULTURES PAS.NR.4/88
~~4/267~~ SIP. S= 2000M2
SIPERFAQE TOTALE . SIP. S= 2000M2 (Ish "Kino Sdudio")
ZONA KADASTRALE 8130, ME INDEKS HARTE TR - I, J - 17, 18
Pergatiti : TOPOGRAF PETRIT KULLOLLI
PETRIT KULLOLLI
Lic. nr. IZ.1371/3
TIRANA - ALBANIA
RR.ALEKSANDER MOJSIU
5/180
~~I/147~~
4/267
4/88
4/88
LULISHTE
4/88 S=2000M2
~~4/267~~
MINISTRIA E KULTURES
4/88
8130
TIRANE
TR; I,J–17,18

VENDIM
Nr. 614, datë 31.8.2016

PËR EKZEKUTIMIN E VENDIMIT TË GJYKATËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT, DATË 7.4.2016, PËR ÇËSHTJEN "KARAGJOZI DHE TË TJERË KUNDËR SHQIPËRISË" (PËR ANKIMIN NR. 32382/11)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 46, të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, ratifikuar me ligjin nr. 8137, datë 31.7.1996, "Për ratifikimin e Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore", të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 13, të ligjit nr. 147/2015, "Për buxhetin e vitit 2016", me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ekzekutimin e vendimit të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, datë 7.4.2016, për çështjen "Karagjozi dhe të tjerë kundër Shqipërisë", për ankimin nr. 32382/11, në shumën 5 919 850 (pesë milionë e nëntëqind e nëntëmbëdhjetë mijë e tetëqind e pesëdhjetë) euro, në lidhje me dëmin pasuror dhe jopasuror, si dhe kostot e shpenzimet, sipas listës së kërkuesve në shtojcën 1, që bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij, plus çdo taksë që mund të jetë e aplikueshme.

2. Vlerat e përcaktuara si detyrim në pikën 1, të këtij vendimi, gjatë ekzekutimit të vendimit, të konvertohen në lekë në bazë të kursit të këmbimit të bankës ku është depozituar shuma, në datën e kryerjes së pagesës.

3. Vlerat e përcaktuara si detyrim në pikën 1, të këtij vendimi, të depozitohen në një nga bankat e nivelit të dytë, në emër të kërkuesve, sipas shtojcës 1 bashkëlidhur këtij vendimi, në vlerën që shteti shqiptar detyrohet, sipas vendimit të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, datë 7.4.2016.

4. Pagimi i shumave të depozituara, sipas përcaktimit në pikën 3, të këtij vendimi, në favor të ankuesve në çështjen "Karagjozi dhe të tjerë kundër Shqipërisë", për ankimin nr. 32382/11, bëhet nga Ministria e Financave pas paraqitjes së dokumentacionit të nevojshëm ligjor për kryerjen e pagesave nga fondi i kontingjencës i buxhetit të shtetit, brenda 3 muajve nga data kur vendimi i gjykatës është bërë përfundimtar.

5. Në rast mospagimi brenda afatit 3-mujor, të përmendur në pikën 4, të këtij vendimi, mbi shumat e mësipërme paguhen interesa të thjeshta, të barabarta me kursin marzhinal të huas së Bankës Qendrore Evropiane, gjatë periudhës së mospagimit, plus tre për qind.

6. Efektet financiare, të parashikuara për ekzekutimin e këtij vendimi, të përballohen nga fondi i kontingjencës i buxhetit të shtetit.

7. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

SHTOJCA 1
LISTA E APLIKANTËVE

Titulli i çështjes dhe nr.	**Emri i aplikantëve (viti i lindjes)**	**Vendqëndrimi**	**Përfaqësuar nga**	**Data e paraqitjes së kërkesës**
Karagjozi dhe të tjerë kundër Shqipërisë ***Aplikimi* nr. 32382/11**	Eni Kokona (1976) Lindita Kokona (1948) Xhejni Kokona (1978) Nirvana Rradheshi (1951) Shpresa Halimi (1969) Dhurata Bungo Karagjozi (1937) Dëshira Efovia Karagjozi (1936) Suzana Gjebrea Çami (1958) Hiqmet Çami (1924)	Shqipëri Shqipëri Shqipëri Shqipëri SHBA Shqipëri Shqipëri Shqipëri Shqipëri	S. Puto, avokat	14 mars 2011

	Hasibe Kulla Çami (1966)	Kanada		
	Besnik Çami (1961)	Kanada		
	Agim Karagjozi (1927)	SHBA		
	Albert Karagjozi (1934)	Shqipëri		
	Vesim Karagjozi (1931)	SHBA		
	Bukuroshe Dobi Karagjozi (1929)	SHBA		
	Armand Viçani (1958)	SHBA		
	Miranda Viçani Telegrafi (1949)	SHBA		
	Diana Kaltani Halimi (1936)	Kanada		
	Ermal Halimi (1959)	Shqipëri		
	Karolina Halimi (1935)	Shqipëri		
	Ariel Halimi (1963)	Shqipëri		

VENDIM
Nr. 615, datë 31.8.2016

PËR EKZEKUTIMIN E VENDIMIT TË GJYKATËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT, DATË 7.4.2016, PËR ÇËSHTJEN "ALIÇKA DHE TË TJERË KUNDËR SHQIPËRISË" (PËR ANKIMET NR. 33148/11, NR. 33151/11, NR. 33823/11, NR. 46103/11, NR. 72334/11 DHE NR. 78960/11)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 46, të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, ratifikuar me nr. 8137, datë 31.7.1996, "Për ratifikimin e Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore", të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 13, të ligjit nr. 147/2015, "Për buxhetin e vitit 2016", me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ekzekutimin e vendimit të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, datë 7.4.2016, për çështjen "Aliçka dhe të tjerë kundër Shqipërisë", për ankimet nr. 33148/11 (Aliçka dhe Vasha), nr. 33823/11 (Tahiri), nr. 46103/11 (Theodhosi), nr. 72334/11 (Nishe dhe të tjerë), nr. 78960/11 (Benussi), sipas listës së ankuesve në shtojcën 1 dhe shumat e përcaktuara në shtojcën 2, bashkëlidhur këtij vendimi dhe që janë pjesë përbërëse e tij, plus çdo taksë që mund të jetë e aplikueshme.

2. Në zbatim të vendimit të GJEDNJ-së, të bëhet ekzekutimi, me mjete të përshtatshme, i vendimeve të ish-Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, të dhëna në favor të ankimit nr. 33151/11 (Kreka), në raport me pjesën takuese të ankuesit, brenda 3 muajve nga data e vendimit tëGJEDNJ-së.

3. Vlerat e përcaktuara si detyrim, në pikën 1, të këtij vendimi, gjatë ekzekutimit të vendimit të konvertohen në lekë, në bazë të kursit të këmbimit të bankës ku është depozituar shuma, në datën e kryerjes së pagesës.

4. Vlerat e përcaktuara si detyrim, në pikën 1, të këtij vendimi, të depozitohen në një nga bankat e nivelit të dytë, në emër të ankuesve, sipas shtojcës 1 bashkëlidhur këtij vendimi, në vlerën që shteti shqiptar detyrohet, sipas vendimit të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, datë 7.4.2016, për secilën çështje.

5. Pagimi i shumave të depozituara, sipas përcaktimeve në pikën 3, të këtij vendimi, në favor të ankuesve "Aliçka dhe të tjerë kundër Shqipërisë", për ankimet nr. 33148/11 (Aliçka dhe Vasha), nr. 33823/11 (Tahiri), nr. 46103/11 (Theodhosi), nr. 72334/11 (Nishe dhe të tjerë), nr. 78960/11 (Benussi), të bëhet nga Ministria e Financave, pas paraqitjes së dokumentacionit të nevojshëm ligjor, për kryerjen e pagesave nga buxheti i shtetit, brenda 3 muajve nga data që vendimi i gjykatës është bërë përfundimtar.

6. Në rast mospagimi brenda afatit 3-mujor, të përmendur në pikën 5, të këtij vendimi, mbi shumat e mësipërme paguhen interesa të thjeshta, të barabarta me kursin marzhinal të huas së Bankës Qendrore Evropiane gjatë periudhës së mospagimit, plus tre për qind.

7. Efektet financiare, të parashikuara për ekzekutimin e këtij vendimi, të përballohen nga fondi i kontingjencës i buxhetit të shtetit.

8. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë, Ministria e Financave dhe Agjencia e Trajtimit të Pronave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

SHTOJCA 1
LISTA E APLIKANTËVE

Nr.	Titulli i çështjes dhe nr.	Emri i aplikuesve (viti i lindjes)	Vendbanimi	Përfaqësuar nga	Data e paraqitjes
1.	*Aliçka dhe Vasha,* nr. 33148/11	Velisha Aliçka (1940) Adriatik Aliçka (1949) Nafije Vasha Aliçka (1942)	Shqipëri Shqipëri Shqipëri	S. Dodbida, avokat	17 maj 2011
2.	*Kreka,* nr. 33151/11	Selami Kreka (1925)	Shqipëri	Asnjë	13 maj 2011
3.	*Tahiri,* nr. 33823/11	Dilaver Tahiri (1944)	Shqipëri	V. Gumi, avokat	24 prill 2011
4.	*Theodhosi* nr. 46103/11	Afërdita Theodhosi (1951)	Shqipëri	Asnjë	6 korrik 2011
5.	*Nishe dhe të tjerë* nr. 72334/11	Petraq Nishe (1938) Irini Shkurti Nishe (1936) Josif Nishe (1938) Ilia Çili (1954) Margarita Tola Çili (1957) Sotir Çili (1962)	Shqipëri Shqipëri Shqipëri Shqipëri Shqipëri Shqipëri	S. Dodbiba, avokat	5 tetor 2011
6.	*Benussi,* nr. 78960/11	Anton Benussi (1938)	Shqipëri	S. Puto, avokat	12 mars 2012

SHTOJCA 2
SHPËRBLIMI I DREJTË

Nr.	Emri i aplikimit dhe numri	Dëmi pasuror dhe jopasuror	Kostot dhe shpenzimet
1.	*Aliçka dhe Vasha,* nr. 33148/11	3200 (tre mijë e dyqind) euro	Asnjë (nuk është paraqitur faturë)
2.	*Kreka,* nr. 33151/11	Asnjë	Asnjë (nuk është paraqitur faturë)
3.	*Tahiri,* nr. 33823/11	34,300 (tridhjetë e katër mijë e treqind) euro	850 (tetëqind e pesëdhjetë) euro
4.	*Theodhosi,* nr. 46103/11	11,800 (njëmbëdhjetë mijë e tetëqind) euro	Asnjë (nuk është paraqitur faturë)
5.	*Nishe dhe të tjerë,* nr. 72334/11	31,300 (tridhjetë e një mijë e treqind) euro	Asnjë (nuk është paraqitur faturë)
6.	*Benussi,* nr. 78960/11	719,000 (shtatëqind e nëntëmbëdhjetë mijë) euro	850 (tetëqind e pesëdhjetë) euro

VENDIM
Nr. 616, datë 31.8.2016

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 1080, DATË 23.12.2015, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR EKZEKUTIMIN E VENDIMIT TË GJYKATËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT, DATË 10.11.2015, PËR ÇËSHTJEN "SHARRA DHE TË TJERË KUNDËR SHQIPËRISË" (PËR ANKIMET NR. 25038/08, 64376/09, 64399/09, 347/10, 1376/10, 4036/10, 12889/10, 20240/10, 29442/10, 29617/10, 33154/11 DHE 2032/12)"

Në mbështetje të nenit 100, të Kushtetutës, të nenit 46, të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, ratifikuar me ligjin nr. 8137, datë 31.7.1996, "Për ratifikimin e Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore", të ligjit nr. 9235, datë 29.7.2004, "Për kthimin dhe kompensimin e pronës", të ndryshuar, të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", dhe të nenit 13, të ligjit nr. 147/2015, "Për buxhetin e vitit 2016", me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Nr. 10 i shtojcës 2 të vendimit nr. 1080, datë 23.12.2015, të Këshillit të Ministrave, ndryshohet, si më poshtë vijon:

"10. Kati, nr. 29617/10, Dëmi pasuror dhe dëmi jopasuror: 117 600 (njëqind e shtatëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind) euro, kostot dhe shpenzimet: 850 (tetëqind e pesëdhjetë) euro.".

2. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 617, datë 31.8.2016

PËR EMËRIMIN NË DETYRË TË DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM TË TEATRIT KOMBËTAR TË OPERËS, BALETIT DHE ANSAMBLIT POPULLOR

Në mbështetje të pikës 2, të nenit 100, të Kushtetutës, dhe të pikave 1 e 3, të nenit 9, të ligjit nr. 10352, datë 18.11.2010, "Për artin dhe kulturën", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Kulturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Znj. Zana Çela emërohet drejtor i përgjithshëm i Teatrit Kombëtar të Operës, Baletit dhe Ansamblit Popullor.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 618, datë 31.8.2016

PËR FINANCIMIN E URDHRIT PROFESIONAL TË MJEKUT VETERINAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 23, të ligjit nr. 113/2015, "Për Urdhrin Profesional të Mjekut Veterinar", me propozimin e ministrit të Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Financimin e Urdhrit Profesional të Mjekut Veterinar për një periudhë njëvjeçare, në masën 12 000 000 (dymbëdhjetë milionë) lekë.

2. Ky fond të përballohet nga buxheti i shtetit për vitin 2016, miratuar për Ministrinë e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave.

3. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 619, datë 31.8.2016

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 33, DATË 20.1.2016, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR FINANCIMIN E SHËRBIMEVE SHËNDETËSORE SPITALORE NGA SKEMA E DETYRUESHME E SIGURIMEVE TË KUJDESIT SHËNDETËSOR PËR VITIN 2016"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5, të aktit normativ nr. 1, datë 29.7.2016, të Këshillit të Ministrave, "Për disa ndryshime në ligjin nr. 147/2015, "Për buxhetin e vitit 2016"", dhe të nenit 10, të ligjit nr. 10383, datë 24.2.2011, "Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shtojca 2, bashkëlidhur vendimit nr. 33, datë 20.1.2014, të Këshillit të Ministrave, zëvendësohet me shtojcën 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i miratuar për spitalet, për vitin 2016.

3. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Financave dhe Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

SHTOJCA 2/1

BUXHETI I SHËRBIMIT SPITALOR 2016

000 lekë

INSTITUCIONI	Buxheti						TOTALI
	600	601	602	604	606	Rezervë	
BERAT	213,200	35,600	163,000				**411,800**
BULQIZË	55,500	9,250	26,600				**91,350**
DELVINË	26,000	4,350	6,000				**36,350**
DEVOLL	34,000	5,650	14,000				**53,650**
DIBËR	199,500	33,300	133,700				**366,500**
ELBASAN	335,600	56,038	333,628				**725,266**
FIER	292,000	48,800	180,342				**521,142**
GRAMSH	86,000	14,450	43,800				**144,250**
GJIROKASTËR	154,600	25,852	130,706				**311,158**
HAS	30,500	5,100	13,000				**48,600**
KAVAJË	88,100	14,700	34,400				**137,200**
KOLONJË	64,200	10,720	22,000				**96,920**
KORÇË	315,600	52,700	208,000				**576,300**
KRUJË	92,800	15,500	26,715				**135,015**
KUÇOVË	45,600	7,600	17,500				**70,700**
KUKËS	174,500	29,100	122,700				**326,300**
KURBIN	58,900	9,800	32,735				**101,435**
LEZHË	176,400	29,500	123,000				**328,900**
LIBRAZHD	102,200	17,100	52,000				**171,300**
LUSHNJË	161,700	27,000	107,586				**296,286**
MALËSI E MADHE	13,300	2,250	6,500				**22,050**
MALLAKASTËR	28,000	4,700	11,906				**44,606**
MAT	92,300	15,400	47,500				**155,200**
MIRDITË	72,000	12,000	32,700				**116,700**
PEQIN	26,100	4,350	7,721				**38,171**
PËRMET	63,500	10,600	28,000				**102,100**

POGRADEC	124,400	20,750	81,700				**226,850**
PUKË	67,300	11,250	38,500				**117,050**
SARANDË	107,800	18,000	100,267				**226,067**
SKRAPAR	70,000	11,700	19,500				**101,200**
SHKODËR	385,571	64,401	240,451				**690,423**
TEPELENË	70,300	11,740	20,500				**102,540**
QSUT	1,791,030	299,106	4,132,062				**6,222,198**
SUOGJ "MBRETËRESHA GERALDINË"	232,100	38,670	254,000				**524,770**
SUOGJ "KOÇO GLIOZHENI"	178,000	29,730	160,000				**367,730**
SU "SHEFQET NDROQI"	216,120	36,100	376,347				**628,567**
TROPOJË	75,900	12,680	37,400				**125,980**
VLORË	311,700	52,050	243,329				**607,079**
SU TRAUMA	12,200	2,020	42,500				**56,720**
Paketat e shërbimeve				1,506,530			**1,506,530**
Trajtime me VKM				100,000			**100,000**
Transferta për individët (mjekë specialistë)					20,000		**20,000**
Pagesa të shërbimeve PPP				245,000			**245,000**
Rezervë						222,047	**222,047**
TOTALI	**6,644,521**	**1,109,607**	**7,672,295**	**1,851,530**	**20,000**	**222,047**	**17,520,000**

VENDIM
Nr. 620, datë 31.8.2016

PËR HAPJEN E PROCEDURËS SË PRANIMIT TË DREJTPËRDREJTË NË TND EDHE PËR KANDIDATË TË TJERË, JASHTË SHËRBIMIT CIVIL, DHE PËR PËRDORIMIN E PROCEDURËS SË PRANIMIT TË DREJTPËRDREJTË NË TND, PËR VITIN 2016

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 27, pika 5, e 29, pika 1, të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", të ndryshuar, dhe në vijim të pikave 2, 3 dhe 4, të kreut V, të vendimit nr. 118, datë 5.3.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për procedurat e emërimit, menaxhimit dhe përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil të nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues dhe të anëtarëve të TND-së", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përjashtimisht për vitin 2016, procedura e pranimit të drejtpërdrejtë në TND është e hapur edhe për kandidatë të tjerë, jashtë shërbimit civil, që plotësojnë kërkesat specifike për pranimin në TND.

2. Për vitin 2016, pranimi në TND të bëhet në mënyrë të drejtpërdrejtë, nëpërmjet një konkursi kombëtar.

3. Numri i pozicioneve, për të cilat do të përdoret procedura e pranimit të drejtpërdrejtë në TND, është 27 (njëzet e shtatë).

4. Kriteret minimale të pranimit për këtë procedurë, për kandidatët nga jashtë shërbimit civil, janë:

a) Të plotësojnë kushtet e përgjithshme të pranimit në shërbimin civil, të përcaktuara në shkronjat "a" deri në "dh", të nenit 21, të ligjit nr. 152/2013, të ndryshuar;

b) Të zotërojnë një diplomë të nivelit "Master shkencor" ose të barasvlershme me të, sipas legjislacionit të arsimit të lartë. Diplomat, të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë njohur paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave, sipas legjislacionit në fuqi;

c) Të kenë, të paktën, 3 vjet përvojë pune në pozicione të mesme drejtuese ose të barasvlershme, në:

- institucione të administratës publike;
- institucione bankare të nivelit të dytë dhe që, aktualisht, nuk kanë detyrime ndaj shtetit ose nuk janë në proces kundër tij;
- shoqëri tregtare, të cilat, sipas legjislacionit në fuqi, konsiderohen si biznes i madh dhe që, aktualisht, nuk kanë detyrime ndaj shtetit ose nuk janë në proces kundër tij;

- organizata jofitimprurëse, të cilat kanë, të paktën, 5 vjet që janë krijuar.

Përjashtimisht kandidatët nga jashtë shërbimit civil, të cilët kanë punuar dhe/ose punojnë në institucione ndërkombëtare brenda vendit, në profesion jashtë vendit, pedagogë në institucione të arsimit të lartë ose avokatë, noterë apo kontabilistë të miratuar, brenda ose jashtë vendit, duhet të kenë, të paktën, 5 vjet përvojë pune, përkatësisht në këto institucione ose në profesion.

ç) Të mos kenë procese gjyqësore civile, penale, administrative, të cilat janë në proces, si dhe të mos jenë në ndjekje penale nga prokuroria.

5. Ngarkohen ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike dhe Departamenti i Administratës Publike për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 621, datë 31.8.2016

PËR LIRIM DHE EMËRIM NË DETYRË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 65, të ligjit nr. 9863, datë 28.1.2008 "Për ushqimin" të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Isuf Shehu, drejtor i përgjithshëm i Autoritetit Kombëtar të Ushqimit (AKU), lirohet nga kjo detyrë.

2. Z. Dritan Sejko emërohet drejtor i përgjithshëm i Autoritetit Kombëtar të Ushqimit (AKU).

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

UDHËZIM
Nr. 17, datë 30.8.2016

MBI ZBATIMIN E VENDIMIT NR. 618, DATË 7.9.2006, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE TË DOKUMENTACIONIT DHE MASËS SË PËRFITIMIT TË PAGESËS PËR PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUAR", TË NDRYSHUAR

Mbështetur në pikën 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në ligjin nr. 9355, datë 10.3.2005, "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore", i ndryshuar, të pikës 27, të vendimit nr. 618, datë 7.9.2006, "Për përcaktimin e kritereve të dokumentacionit dhe masës së përfitimit të pagesës për personat me aftësi të kufizuar", i ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Masa e përfitimit të aftësisë së kufizuar, të përcaktuar në nenin 8, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 618, datë 7.9.2006, të ndryshuar, bëhet 10.140 (dhjetë mijë e njëqind e dyzetë) lekë në muaj për personat e përcaktuar në pikën 1 të vendimit. Të njëjtën masë përfiton edhe kujdestari i personit me aftësi të kufizuar.

2. Masa e përfitimit të aftësisë së kufizuar, të përcaktuar në nenin 8, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 618, datë 7.9.2006, të ndryshuar, bëhet 10.140 (dhjetë mijë e njëqind e dyzetë) lekë në muaj për personat e përcaktuar në pikën 2 të vendimit dhe 10.650 (dhjetë mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë) lekë në muaj për kujdestarin.

3. Efektet financiare, për zbatimin e këtij udhëzimi, fillojnë nga 1 shtatori i vitit 2016 dhe përballohen me fondet e akorduara për vitin 2016, për Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë.

4. Udhëzimi nr. 22, datë 20.8.2015, i ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, shfuqizohet.

Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga 1.9.2016.

MINISTRI I MIRËQENIES SOCIALE DHE RINISË
Blendi Klosi

UDHËZIM
Nr. 18, datë 30.8.2016

MBI ZBATIMIN E VENDIMIT NR. 277, DATË 18.6.1997, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRFITIMET NGA STATUSI I TË VERBRIT", TË NDRYSHUAR

Mbështetur në pikën 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në ligjin nr. 9355, datë 10.3.2005, "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore", i ndryshuar, të pikës 16 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 277, datë 18.6.1997, "Për përfitimet nga statusi i të verbrit", të ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Masa e përfitimit për shkak të verbërisë, të përcaktuar në pikën 4 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 277, datë 18.6.1997, të ndryshuar, bëhet 11.510 (njëmbëdhjetë mijë e pesëqind e dhjetë) lekë në muaj. Të njëjtën masë përfiton edhe kujdestari i të verbrit.

2. Efektet financiare, për zbatimin e këtij udhëzimi, fillojnë nga 1 shtatori i vitit 2016 dhe përballohen me fondet e akorduara për vitin 2016, për Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë.

3. Udhëzimi nr. 24, datë 20.8.2015, i ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, shfuqizohet.

Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga 1.9.2016.

MINISTRI I MIRËQENIES SOCIALE DHE RINISË
Blendi Klosi

UDHËZIM
Nr. 19, datë 30.8.2016

MBI ZBATIMIN E VENDIMIT NR. 31, DATË 20.1.2001, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRFITIMET NGA STATUSI I INVALIDIT, PARAPLEGJIK DHE TETRAPLEGJIK", TË NDRYSHUAR

Mbështetur në pikën 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në ligjin nr. 9355, datë 10.3.2005, "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore", i ndryshuar, të pikës 8, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 31, datë 20.1.2001, të Këshillit të Ministrave, "Për përfitimet nga statusi i invalidit, paraplegjik dhe tetraplegjik", i ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Masa e përfitimit për invalidët paraplegjikë dhe tetraplegjikë, të përcaktuar në pikën 4, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 31, datë 20.1.2001, të ndryshuar, bëhet 10.140 (dhjetë mijë e njëqind e dyzetë) lekë në muaj.

2. Masa e përfitimit për kujdestarin e invalidit paraplegjikë dhe tetraplegjikë, të përcaktuar në pikën 4, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 31, datë 20.1.2001, të ndryshuar, bëhet 10.650 (dhjetë mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë) lekë në muaj.

3. Efektet financiare, për zbatimin e këtij udhëzimi, fillojnë nga 1 shtatori i vitit 2016 dhe përballohen me fondet e akorduara për vitin 2016, për Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë.

4. Udhëzimi nr. 23, datë 20.8.2015, i ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, shfuqizohet.

Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga 1.9.2016.

MINISTRI I MIRËQENIES SOCIALE DHE RINISË
Blendi Klosi

URDHËR
Nr. 5993, datë 7.9.2016

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës, nenit 7, pikës 2, të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001, "Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë", të ndryshuar, të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", si dhe të nenit 11, pikës 2 dhe 3, të ligjit nr. 90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore",

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Ministrisë së Drejtësisë, nga data 7.9.2016, ora 17:00, deri në datën 9.9.2016, ora 11:00, zëvendësministrit të Drejtësisë, z. Arben Isaraj.

2. Ngarkohet zëvendësministri, z. Arben Isaraj, për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I DREJTËSISË
Ylli Manjani

KËRKESË
Nr. 4266, datë 2.9.2016

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor "By-Pass Vlorë (objekte)". Subjekti kërkues, i këtij objekti, është Autoriteti Rrugor Shqiptar. Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkojmë të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur, në bazë të vendimit nr. 138, datë 23.3.2000 të Këshillit të Ministrave, "Për kriteret teknike të vlerësimit dhe përllogaritjes së masës së shpërblimit për pasuritë pronë private që shfronësohen të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik", i ndryshuar, për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Pronarët që kanë emrin në listën emërore dhe personat e tretë, brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre lidhur me çmimin, sipërfaqen titullin e pronësisë apo llojin e pasurisë që kanë në pronësi, të shoqëruara me dokumentet përkatëse në ministrinë kompetente (Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës).

Ky publikim bëhet për pasuritë e llojit "objekt".

Pronarët do të kompensohen për efekt shpronësimi pas miratimit të kërkesës për shpronësim nga Këshilli i Ministrave dhe pasi të kenë paraqitur dokumentacionin respektiv të pronësisë pranë Autoritetit Rrugor Shqiptar (subjekti kërkues në bazë të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimin dhe marrjen në përdorim të përkohshëm, të pasurisë pronë private për interes publik".

Vlera totale e shpronësimit është 23 643 895 (njëzet e tre milionë e gjashtëqind e dyzetë e tre mijë e tetëqind e nëntëdhjetë e pesë) lekë.

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM I
MINISTRISË
SË TRANSPORTIT DHE
INFRASTRUKTURËS
Eduart Seitaj

REPUBLIKA E SHQIPERISË

MINISTRIA E TRANSPORTIT DHE INFRASTRUKTURES

AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR

SEKTORI SHPRONESIMEVE

LISTA E PRONAREVE QË SHPRONËSOHEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR "BY PASS-VLORË" (shtesa)

	PRONARI					Sipërfaqe ndërtimi						
NR	Emri	Atesia	Mbiemri	Z.Kad	Nr.Pasurise.	Sip. Ndertimi m2	Lloji I Ndërtimit	Sipërfaqe Ndërtimi Vlefta leke/m2	Vlefta Sipërfaqe Ndërtimi	Vlefta ne leke Bodrumi	Vlefta totale ne leke	Shënime
1	SMAIL	AVNI	LALAJ	8605	6/146	120	Objekt Banimi	60120	7214400	1573302	8787702	Akt Marrëveshja ligj. Nr.8/2012 dt.09.02.2012
2	PETRIT		HODAJ	1060	320	785	Objekt Biznesi		10433340		10433340	Akt Marrëveshja ligj. Nr.8/2012 dt.09.02.2013
3	BESIM		LAMAJ	2074	1019	49.6	Objekt Banimi		532131		532131	Akt Marrëveshja ligj. Nr.8/2012 dt.09.02.2014
4	BESIM		LAMAJ	2074	1019/2	81	Objekt Banimi		1377245		1377245	Akt Marrëveshja ligj. Nr.8/2012 dt.09.02.2015
5	BESIM		LAMAJ	3140	zone e pa menaxhuar	38	Objekt Biznesi		997837		997837	Akt Marrëveshja ligj. Nr.8/2012 dt.09.02.2016
6	SADETE	VEHBI	SKENDAJ	3140	zone e pa menaxhuar	58	Objekt Banimi		1515640		1515640	Akt Marrëveshja ligj. Nr.8/2012 dt.09.02.2017
	SHUMA								22070593		23643895	

KËRKESË
Nr. 4810, datë 2.9.2016

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Zhvillimit Urban shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private që preken nga realizimi i projektit "Sistemimi i bllokut të banimit në lagjen "Kongresi i Lushnjës", pallati 31, tek ish-kinemaja", Lushnjë.

Subjekti kërkues i këtij objekti është Bashkia Lushnjë.

Me anë të këtij publikimi, kërkojmë të vëmë në dijeni personin, i cili preket nga ky shpronësim, që konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur në bazë të vendimit nr. 138, datë 23.3.2000, të Këshillit të Ministrave, "Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik", të ndryshuar, si dhe të vendimit nr. 89, datë 3.2.2016, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë", për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Vlera totale e shpronësimit është 1,401,137 (një milion e katërqind e një mijë e njëqind e tridhjetë e shtatë) lekë.

ZËVENDËSMINISTRI I ZHVILLIMIT URBAN
Alfred Dalipi

Tabela e Pasurive qe shpronesohen , qe preken nga zbatimi i Projektit "Sistemim i bllokut te banimit ne Lagjen Kongresi I Lushnjes"

Nr	Pronari		Zona Kadastrale	Nr. pasurise	Lloji i ndertimit	Siperfaqja		Cmimi		Vlera		Vlera gjithsej truall+ndretese	Konfirmimi I ZVRPP-se
	Emer	Mbiemer				Truall	Ndertese	Truall	Ndertese	Truall	Ndertese		
						m2	m2	lek	lek	lek	lek		
1	Entela	Begaj	8571	18/10-N17	Njesi +truall	33	33	9709		320397	1080740	1401137	Konfirmuar Nr.2530/1prot ,dt 19.06.2016
										Shuma total		1401137	

	Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2016

Adresa:
Bulevardi "Gjergj Fishta"
pas ish-Ekspozitës "Shqipëria Sot"
Tel: 042427005, 04 2427006

Çmimi 140 lekë